



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Diskutim me komunitetin shqiptar në Graz

Projektiligji për Diasporën dhe Projekt-Strategjia(2019-2023)

Përmbledhja e rekomandimeve

Graz, tetor 2018

© 2018 Germin

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Germin ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr."Tringë Smajli". Nr.48

10000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: germinks@gmail.com

Web: www.diasporaflet.org

Autor: GERMIN

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Mirënjohje

Germin i është shumë falënderues pjesëmarrësve të takimit që kanë gjetur kohën për të marrë pjesë dhe për të shprehur rekomandimet, sfidat dhe kërkesat e diasporës ndaj projektligjit dhe projekt-strategjisë për Diasporën. Ekipi i është gjithashtu mirënjohës *Këshillit Koordinues të Shoqatave Shqiptare për Steiermark* për mbështetjen e tyre në organizimin e këtij takimi.

Qëllimi i Raportit & Metodologjia

Takimi me diasporën shqiptare u organizua në Graz të Austrisë nga Germin, një organizatë joqeveritare e përqëndruar në Kosovë me fokus në hulumtimin e diasporës. Ky bashkëbisedim u organizua si pjesë e projektit *Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave*. Qëllimi gjithëpërfshirës i këtij projekti është që të lehtësojë kontributin e Diasporës në Kosovë gjatë procesit të hartimit të politikave dhe strategjive, në veçanti të *Strategjisë së Diasporës (2019 -2023)*, *Planit të Veprimit (2019-2021)* dhe *Projektligjit për Diasporën*.

Përmes kësaj nisme synohet:

- Avancimi i zërit të Diasporës në hartimin e politikave dhe strategjive me anë të forumeve dhe kanaleve të reja teknologjike;
- Të përfshihen aftësitë dhe njohuritë e pjesëtarëve të Diasporës që proceset gjatë zhvillimit të politikave dhe legjislationit;
- Të fuqizohen pjesëtarët e shtatë task forcave të krijuara nga Germin për të marrë pjesë në proceset politikëbërëse në Kosovë.

Ky raport në nxjerrë në pah sfidat, kërkesat dhe rekomandimet kryesore të anëtarëve të diasporës në Graz dhe vendet të tjera të Austrisë. Takimi në Graz u mbajt me datë 20 tetor 2018, si pjesë e aktivitetëve të Germin në Diasporë në kuadër të projektit *Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave*.

Pjesë e këtij takimi ishin 21 anëtar të diasporës (15 burra dhe 6 gra) që përfqësonin shoqata, grupe të profesionistëve, studentë, dhe biznese të ndryshme nga Viena, Graz, Sank Pölten, Salzburg, Knittelfeld dhe Kapfenberg. Takimi u organizua në tre pjesë: Projekt - Stratgjia për Diasporën (2019-2023), ishte dokumenti që u diskutua në pjesën e parë, për të vazhduar punën me Planin e Veprimit (2019-2021) dhe në pjesën e tretë të takimit u diskutua për Projektligjin për Diasporën. Pjesëmarrësit në këto tre pjesë të takimit patën mundësinë që drejtëpërdrejt të kalojnë rekomandimet e tyre në këto dokumente ku bëhet fjalë për zbatimin e të drejtave të tyre politike, socio-ekonomike dhe kulturore në vendin e origjinës.

Gjuha e përdorur përgjatë takimit ishte gjuha shqipe dhe të gjithë pjesëmarrësit identifikohen si shqiptarë, por diversiteti i tyre përfaqëson një sërë opinionesh, perspektivash dhe temash të identifikuar në këtë raport. Pjesëmarrësit në këtë takim përfaqësonin fusha dhe profesione të ndryshme (p.sh. arsim, studentë, ekonomist, gazetar, përfaqësues shoqatave kulturore, politikan, përfaqësues biznesesh, etj.) me prejardhje nga Kosova dhe Shqipëria.

Rekomandimet kryesore të dalura nga takimi në Graz

Pas diskutimeve në këtë takim dolën këto rekomandime që Ministria Diasporës dhe Investimeve Strategjike duhet t'i merr për bazë në përpilimin final të këtyre dokumenteve që drejtëpërdrejt prekin interesat e anëtarëve të diasporës.

Mësimi plotësues

Mësimi plotësues i gjuhës shqipe në diasporë vlerësohet si një proces mjaft i rëndësishëm, ngase gjuha është një tregues i rëndësishëm i identitetit tonë që përfaqëson një histori të tërë kulturore, andaj për ta ruajtur atë duhet një angazhim i dyanshëm si prej institucioneve, poashtu, edhe prej anëtarëve të diasporës. Ky proces ishte dhe vazhdon të jetë një ndër prioritetet kyçe për Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, si tani, poashtu edhe në të kaluarën. Të pranishmit, të cilët përfaqësonin ide *pro* dhe *kundër* rreth rolit të shtetit të Kosovës për mbarëvajtjen e mësimin plotësues, potencuan mes tjerash sfidat me pedagogët të cilët po dërgohen me mision në Austri, që sipas tyre kanë kualifikime mesatare për mësimdhënie.

“Të hapen qendra interaktive për aftësimin e gjeneratave të reja të mësuesve në diasporë, si dhe të krijohet një aplikacion për mësimin në distancë për nxënësit shqiptarë në diasporë”.

“Shtetet shqiptare duhet të llojnë në krijimin e mundësive që gjuha shqipe të jetë lëndë zgjedhore nëpër shkolla, pasi që në Austri ka 23 gjuhë që ofrohen nëpër shkolla si lëndë zgjedhore”.

“Të krijohen mundësitë dhe hapësira për studentët e rinj të ardhur në Austri për të ndihmuar mësimin plotësues duke ofruar kurse për gjuhën shqipe”.

Të krijohet një këshill që përbëhet nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit. Më shumë rekomandime për këtë temë mund t'i gjeni në shtojcën 1.

Qendrat kulturore

Edhe pse në ligjin aktual janë të parapara Qendrat Kulturore në Diasporë, në projektligj është propozuar një formë tjetër e krijimit dhe funksionalizimit të tyre në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë. Kjo pjesë e projektligjit është shumë e paqartë për shumë anëtarë të diasporës, poashtu shumica prej tyre nuk pajtohen me formën që ministria të hapë Qendrat e Kulturës në Diasporë.

Sipas pjesëmarrëve, qëllimi primar i Qendrave Kulturore do të ishte akomodimi i nevojave të komunitetit duke qenë si zyre ndërlidhëse në mes të shtetit pritës dhe komunitetit për promovimin e kulturës, artit, traditës, shkëmbimin e njohurive, etj.

“Çdo regjion me komunitet me numër të konsiderueshëm shqiptarë në Austri duhet të ketë një qendër kulturore ku realizohen aktivitete të ndryshme si: turne, sport, kulturë, një zyrë ku ofrohen mësimet të gjuhës shqipe, etj”.

“Krijimi i një instituti të diasporës që ruan dhe paraqet kulturën shqiptare në diasporë, bashkon komunitet përmes edukimit dhe shkëmbimeve ndër-kulturore”.

“Krijimi i Qendrave Kulturore në Diasporë të formohen të bazuara në modelin e British Council ¹(një organizatë ndërkombëtare - humanitare qeverisur nga Royal Charter dhe një organ publik nga Mbretëria e Bashkuar)”.

“Në ligj të mos specifikohet zgjedhja e drejtorit apo edhe detajet e tjera, por kjo duhet të rregullohet me akte nënligjore”.

“Të hapen Qendra Kulturore të cilat raportojë për kryerjen dhe mos-kryerjen të aktiviteteve/detyrave në Parlamentiin e Kosovës.”

Më shumë rekomandime për këtë temë mund t'i gjeni në shtojcën 1.

Përfaqësimi i diasporës në vendimmarrje dhe shkëmbimi i përvojave

Roli dhe potenciali i diasporës po merr çdo ditë e më shumë vëmendje nga politikëbërësit, hulumtuesit dhe publiku dhe në të njëjtën kohë po i kushtohet më shumë hapësirë në strategjitë zhvillimore të vendeve të ndryshme. Krijimi i lidhjeve në mes të anëtarëve të diasporës dhe institucioneve të vendit të origjinës është një proces që kërkon angazhim dhe përkushtim të veçantë. Mënyra e çasjes ndaj një procesi të tillë është përcaktuese e nivelit të angazhimit dhe përfshirjes së diasporës në institucionet e shtetit dhe proceset tjera shoqërore të vendit të prejardhjes.

Mos-besimi i shumë anëtarëve të diasporës tek institucionet publike, krijoj debatin tek pjesëmarrësit se a duhet anëtarët e diasporës të përfshihen në vendimmarrje e politikëbërje në vendet e origjines.

“Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike përmes politikave dhe aktivitete të fokusohet në ruajtjen e identitetit, të punohet në programe të ndryshme që mos të vijmë afër asimilit”.

Sa i përket përfaqësimi të Diasporës në politikëbërje, pjesëmarrësit shprehën mendime të ndryshme në këtë drejtim:

Përfaqësim përmes ulëseve të rezervuara në Parlamentin e Kosovës: *Me anë të përfaqësimit të diasporës në Parlament, do të strukturohet dhe organizohet diaspora duke i trajtuar nevojat dhe kërkesat e tyre.;*

Integrim dhe përfaqësim i komunitetit në politikën e vendit pritës: *Ndryshimet pozitive në komunitet mund të ndodhin atëherë kur kemi zëra të fuqishëm shqiptarë brenda partive më të mëdha politike.*

Ky grup në Graz, poashtu dha rekomandim sa i përket Regjistrin të Diasporës, duke kërkuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike më shumë aktivitete në këtë drejtim, si dhe informim të saktë rreth këtij procesi.

¹ British Council Kosovo www.kosovo.britishcouncil.org

Çdo anëtarë i Diasporës i cili blen polisën kufitare për hyrje në Kosovë, të njoftohet për rëndësinë e regjistrimit të diasporës.

Sfidat

Një ndër sfidat kryesore për anëtarët e diasporës në Austri është numri i vogël i nxënësve shqiptarë që vijojnë mësimin plotësues, si dhe mungesa e vetëdijes tek prindërit për rëndësinë e gjuhës dhe kulturës shqipe, duke mos ia kushtuar rëndësinë e njejtë sikurse mësimëve për religjion.

Sfidë tjetër është mungesa e një dialogu të dy-anshëm në mes të institucioneve të shtetit dhe komunitetit jashtë vendit. Anëtarët e diasporës deklaruan se kanë mungesë të informacioneve për zhvillimet dhe programet e ndryshme që inicohen nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike apo edhe ndonjë institucioni tjetër që lidhet me temën e diasporës.

Kërkesat:

Kërkesa kryesore e grupit ishte që shteti i Kosovës të angazhohet në rikthimin e besimit tek anëtarët e Diasporës, i cili mund të arrihet përmes adresimit të kërkesave dhe nevojave të tyre kyçe në Projektligj dhe Projekt-Strategji.

SHTOJCAT:

1. Mësimi plotësues

- Krijimi i një instituti për mësimdhënësit e rinj apo përmes kanaleve të teknologjisë të mundësohet aftësimi i këtyre mësuesve për mësimin plotësues;
- Aplikacion për mësimin në distancë për nxënësit shqiptarë në diasporë;
- Promovimi dhe vetëdijësimi përmes formave të ndryshme për rëndësinë e mësimin të gjuhës shqipe;
- Shtetet shqiptare të krijojnë mundësinë e ofrimit të gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore. Ka 23 gjuhë zgjedhore në shkollat austriake, pse të mos ofrohet edhe gjuha shqipe;
- Nëpërmjet mediave sociale të targetohen prindërit, të promovohet rëndësia e mësimin të gjuhës shqipe, të bëhen promovime atraktive dhe stimuluese;
- Të ofrohet ndihmë për nxënësit shqiptar në lëndë të ndryshme nga studentët shqiptarë në Austri, në ndër to edhe gjuha shqipe;
- Të bëhet institucionalizimi i gjuhës shqipe në diasporë;
- Të krijohet një qendër interaktive për të trajnuar mësues të rinj në Diasporë, duke shfrytëzuar teknologjitë;
- Të ofrohet një vit stazh në vendin e origjinës për pedagogët shqiptarë që kanë përfunduar studimet në Austri;
- Austria ka pedgog shumë të mirë, dhe nuk është e nevojshme të vijin nga Kosova, por qëllimi është që të mësohet gjuha shqipe përmes vizitave studimore;
- Sa më shumë fushata marketingu për rëndësinë e gjuhës dhe mësimin plotësues;
- Mungon vetëdijësimi i prindërve për t'i dërguar në shkollë dhe për t'i mësuar fëmijët në mësim plotësues ;
- Krijimi i këshillit nxënës, prindër dhe mësues;
- Shteti të krijojë kushtëzime për mësimin plotësues;

2. Qendrat kulturore

- Të mos krijohen Qendrat e reja Kulturore në Diasporë, por të ofrohet ndihmë nga ministria në ngritjen e kapaciteteve të shoqatave aktuale në diasporë, qoftë ajo në ndihmë e vogël financiare apo teknike,
- Çdo regjion në Austri duhet të ketë një qendër kulturore ku realizohen aktivitete të ndryshme si: turne, sport, kulturë, një zyrë ku ofrohen mësim të gjuhës shqipe,etj;
- Krijimi i një instituti të diasporës, ku do punonin ekspertë që njohin fushën e diasporës dhe do të ndihmonin direkt me çështjet e diasporës;

- Numri i madh i administratës nëpër ambasada në krahasim me ambasadat e tjera, e bën të panevojshëm prezencën e atasheut për diasporën;
- Brenda qendrave kulturore të ketë kafene, restorante, konvikte, dhe të jetë një vend i përbashkët i kulturës që akomodon nevojat e komunitetit të diasporës, si një urë lidhëse në mes të vendasve dhe komunitetit;
- Të reduktohet numri i madh i stafit në ambasada dhe të financohet atasheja, i cili mbikqyrë shoqatat dhe është përkrahës në terren;
- Qendrat kulturore duhet të jenë të pavarura, mirëpo duhet t'i japin përgjegjësi qeverisë së Kosovës, parlamentit, etj;
- Përfaqësuesi i Qendrave Kulturore duhet të jetë nga diaspora;
- Ndhimë në motivim kombëtar të organizmit të Qendrave Kulturore duhet të ipet nga ministria e jo domosdoshmërisht ndihmë financiare, sepse atëherë Qendrat Kulturore do të jenë qendra klientelizmi për partitë politike;
- Të krijohen statute për Qendrat e Kulturës, të cilat rregullojnë çështjet administrative, psh. të caktohet mosha e udhëheqësit, të njohin të paktën dy gjuhë të huaja, etj;
- Qendrat Kulturore fundjavave të ofrojnë lloje të ndryshme të aktiviteteve të sportit, vallëzimit, mbledhjeve, koncerteve ku do të stimulonte prindërit dhe komunitetin që të vetëdijesohen për mësimin plotësues. Ky do të ishte edukim jo-formal;
- Të krijohen më shumë modele si Shkolla Diasporës për të lidhur të rinjtë me vendin amë;
- Krijimi i Qendrave Kulturore në modelin e British Council do ishte ideale;
- Në ligj nuk duhet të specifikohen zgjedhje e drejtorit apo edhe detajet e tjera, por të rregullohen me akte nënligjore;
- Austria ka nevojë për atashe kulturor, ngase ambasadorët nuk mundën të përfshihen në të gjitha aktivitetet, por më mirë është të reduktonte stafin e misionëve diplomatike;
- Qendra Kulturore të raportojë për kryerjen dhe mos-kryerjen e aktiviteteve/detyrave në Parlament, dhe të mos financohet nga Shtetit;

3. Përfaqësimi

- Të ndryshohet kushtetuta që të lejohet përfaqësimi anëtarëve të diasporës, dhe ky përfaqësim të mos jetë përmes partive politike;
- Duhet të mundohemi që të përfaqësohet diaspora në vendet ku jetojnë e jo në Kosovë, e vetmja gjë që duhet ministria të bëjë është ruajtja e identitetit;
- Duhet të ketë vende të rezervuara në Parlament për diasporën;
- Krijimi i një partie politike të diasporës;

- Me anë të përfaqësimit të diasporës në Parlament, do të ngjallim dhe do të organizojnë diasporën duke i pranuar nevojat dhe kërkesat e diasporës;

4. Të tjera

- Regjistri i diasporës të bëhet në pika kufitare;
- Të formohen Qendrat informative në Kosovë për Diasporën si nevojë për t'u informuar dhe për t'u adresuar kërkesat dhe nevojat e komunitetit;
- Të specifikohet në ligj a kanë të drejta të barabarata ata që kanë shtetësi të dytë të Kosovës;
- Shteti duhet të krijoj programe për kthim, përshkak të rrezikut nga asimilimi;

Rreth Germin:

Germin është organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet digjitale për të lidhur dhe angazhuar diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre amë. Ne përqipemi të eksplorojmë dhe përdorim kanalet e TIK-ut për të lehtësuar më mirë dhe fuqizuar lidhjet mes diasporës, qytetarëve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor. Germin drejtohet nga një grup i profesionistëve të diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informimit dhe teknologjisë, juridikut dhe edukimit, sigurisë dhe mbrojtjes. Germin ka një rrjet prej 130 profesionistësh dhe bashkëpunëtorëve me kohë të pjesshme, që aktualisht jetojnë në 24 shtete përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore. Germin po ashtu ka një rrjet prej 242 organizatave partnere në Diasporë përfshirë Europën, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadanë, Azinë dhe Australinë.

Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).